



## Enti për shkollën popullore

Amt für Volksschule, Davidstrasse 31, 9001 St.Gallen

Informacion për prindërit e  
nxënëseve dhe nxënësve të ciklit të lartë

Alexander Kummer  
drejtori  
Enti për shkollën popullore  
Davidstrasse 31  
9001 St.Gallen  
T 058 229 32 23  
alexander.kummer@sg.ch

St.Gallen në shkurt 2022

### Informacion për kryerjen e caktimit të gjendjes “Stellwerk” 2022


Të nderuar prindër  
Të nderuar mbajtës të përgjegjësive prindërore

Në Kantonin St.Gallen, të gjitha nxënëset dhe të gjithë nxënësit e kryejnë në ciklin e dytë dhe të tretë të lartë caktimin e gjendjes të bazuar në kompjuter “Stellwerk” në fusha të ndryshme mësimore. Këto caktime kontribuojnë, që arritjet shkollërore të mund të krahasohen, dhe përkrahin nxitjen e qëllimshme gjatë kalimit në botën profesionale ose në shkolla të mëtejshme.


Ky caktim i gjendjes shkollërore “Stellwerk” që nga viti shkollor 2017/18 është një pjesë të sistemit për nxitjen e mësimi “Lernpass plus”. Platforma Online e bazuar në planin mësimor të shkollës popullore të Kantonit St.Gallen e ka drejtimin në nxitjen individuale. Mësues si dhe nxënëse dhe nxënës përdorin sistemin “Lernpass plus” për ta caktuar përparimin mësimor brenda një viti shkollor ose gjatë gjithë kohës së ciklit të lartë dhe për të thelluar kompetenca.

“Stellwerk” është një test përshtatës. Do të thotë, që mënyra e zgjidhjes së fëmijës tuaj e cakton ecjen e testit. Pas çdo detyre të zgjidhur programi zgjedh një detyrë të re me gradën e përshtatur të vështirësisë. Në varësi nga ecja e testit kështu zgjidhen detyra më të thjeshta ose më të vështira. Kur sistemi posedon mjaft informacione të besueshme për gjendjen e arritjes, ai e mbyll testin. Mund të testohen fushat mësimore të gjermanishtes, të matematikës, të anglishtes dhe të frëngjishtes. Rezultatet e të gjitha caktimet e kryera të gjendjes shfaqen në një profil personale “Stellwerk”.

Profili “Stellwerk” mund të shërbejë si ndihmë orientuese gjatë zgjedhjes së profesionit, nga që rezultatet në “Stellwerk” mund të krahasohen me të dhënat e profileve të profesioneve të ndryshme të formimit profesional. Kështu fëmija juaj merr udhëzime për kompetencat e nevojshme shkollërore, mbi të cilat bazohet shkolla profesionale në fillimin e formimit profesional, dhe mund të planifikojë qëllimet e tij gjatë kohës së mbetur shkollërore në mënyrë të përshtatshme. Në realizimin e këtyre qëllimeve personale, adoleshentët mbështeten përmes sistemit të nxitjes mësimore “Lernpass plus” dhe nga ana e mësuesit.



### Profili "Stellwerk"



### Krahasin me të dhënat e profileve të profesioneve të ndryshme të formimit profesional

Në profilin "Stellwerk", rezultati i testit për matematik, gjermanisht, frëngjisht dhe anglisht nxirret me një vlerë totale. Kjo vlerë llogaritet në bazë të të gjitha detyrave të përpunuara në fushën mësimore dhe është midis 200 dhe 800 pikave. Për planifikimin e nxitjes janë në dispozicion rezultatet individuale.

Me shumë informacione për "Stellwerk" ose "Lernpass plus" i gjeni në faqen [www.lernpassplus.ch](http://www.lernpassplus.ch).

Me respekt

Alexander Kummer  
Drejtor